



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 75 datë 2 2025

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË BUXHETIT DHE
VLERËSIMIN E PËRGJITHSHËM FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-GUSHT
2025 ,BASHKIA PËRMET**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin Nr. 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”,i ndryshuar, neni 48 “ Monitorimi dhe zbatimi i buxhetit vendor”, Ligji nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzim nr.2 datë 24.01.2025 ‘Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025” Udhëzim nr.35 datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetqeverisjes vendore”, Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin e monitorimit të Buxhetit dhe vlerësimin e përgjithshëm financiar , për periudhën 8-mujore,viti 2025,për Bashkinë Përmet.
2. Ky vendim shpallet menjëherë dhe hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI



**RAPORT I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË
BUXHETIT 8M VITI 2025
BASHKIA PËRMET**

SHTATOR 2025



REALIZIMI I TE ARDHURAVE TE BASHKISË PËR 8 M E VITIT 2025

REALIZIMI I BUXHETIT PËR 8 M E VITIT 2025

PROGRAMI AA135 : PLANIFIKIM DHE MENAXHIM

PROGRAMI AB135 : SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNITARE DHE INFRASTRUKTURA

PROGRAMI AC135: ARSIMI DHE KUJDESI SOCIAL

PROGRAMI AD135: ARGËTIM DHE ZHVILLIM

PROGRAMI AE135: SIGURIA E QYTETARIT DHE MBROJTJA E MJEDISIT

PROGRAMI AF135: REZERVA DHE KONTIGJENCA

MINISTRITË E LINJËS

PROJEKTE

VLERËSIMI I SITUATËS FINANCIARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

Përmet, më .09.2025

RELACION

Monitorimi i realizimit të buxhetit të 8- mujorit të parë, për vitin 2025 dhe vlerësimi i situatës financiare

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 9 datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2 datë 24.01.2025, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025” si ligjin nr 68/2017 date 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore “ të ndryshuar, , ligjin nr. 10296 date 8.7.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, VKB nr.107, datë 18.12.2024, “Për buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2025” i ndryshuar po ju paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën e 8-mujorit të parë viti 2025.

Bashkia Përmet administron dhe menaxhon fondet publike në përputhje me programet buxhetore, në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2025, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026–2028”. Zbatimi bazohet në Shtojcën nr. 5 të këtij udhëzimi, e cila përcakton “Metodologjinë e re të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2026–2028 dhe Buxhetit 2026” për bashkitë: Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shkodër, Shijak, Belsh, Fier, Patos, Fushë Arrëz, Skrapar, Mat, Delvinë dhe për qarqet: Shkodër, Gjirokastrë dhe Korçë.

Në këtë kuadër, struktura e programeve të buxhetit vendor të Bashkisë Përmet do të paraqitet si më poshtë:

Bashkia Përmet (135)

Kodi Emërtimi

- AA135 Planifikim dhe Menaxhim
- AB135 Shërbimet Publike Komunitare dhe Infrastruktura
- AC135 Arsimi dhe Kujdesi Social
- AD135 Argëtim dhe Zhvillim
- AE135 Siguria e Qytetarit dhe Mbrojtja e Mjedisit
- AF135 Rezerva & Kontigjenca

REALIZIMI I TË ARDHURAVE VENDORE 8 - MUJORI 2025

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Paketën Fiskale të vitit 2025, miratuar me VKB nr.96, datë 27.11.2024, Sektori i Tatim Taksave Aseteve dhe Licencave, si dhe duke bashkpunuar dhe me sektor të tjerë të cilët në punën e tyre janë pjesë vjeljes së të ardhurave vendore, gjatë periudhës Janar -Gusht 2025, është bërë një punë e mirë për të arritur objektivat e planifikuara në fillim të vitit .

Të ardhurat të cilat janë planifikuara për tu mbledhur nga ky sektor në vitin aktual 2025, janë të ardhura Tatimore dhe Jo Tatimore, të cilat specifikohen si më poshtë.:

TE ARDHURA TATIMORE

Taksa mbi ndertesat

Taksë mbi truallin

Tatim I thjeshtuar mbi fitimin

Takse e ndik.infr.nd.reja dhe
legalizimet

Takse mbi kalimin e te drejtes se
prones.

Takse Rregjistrim automjeti

Takse Tabele

Taksë mbi tokën bujqësore

Taksë fjetje në hotel

Tatim mbi të ardhurat personale

Takse shitje pasuri e paluajtshme

TE ARDHURA JOTATIMORE

Tarife Pastrimi

Tarife Ndricimi

Tarife Gjelberimi

Leje Rregjistrim Veprimtarie

Qera Objekti

Te ardhura nga kopeshti dhe
cerdhja

Tarife Parkimi

Tarifë për lëndë drusore

Tarifë zënie hapësirë publike

Tarifë kullotje bagëtije

Tarifë mirëmbajtje kanale vaditës

Të ardhura nga ndermarret dhe
pronesia

Tarifa vendore nga urbanistika

Tarifa shërbimesh të MNZ

Takse vendore uji

Te tjera te ardhura

Certifikate perdorimi

Tarife vendore per shqyrtim ose

nxjerje dosje

Qera toke bujqesore





TABELA E PLANIT TE TE ARDHURAVE


Janar-Gusht 2025


NR	LLOJI I TE ARDHURAVE	PLANI				
					% faktit 8 m me plani n 8 m	diferen ca
		VJETOR	Gusht	Fakt 8 mujor		
A	TE ARDHURA TATIMORE	34625	27756	22835	82	- 4921
1	Taksa mbi ndertesat	12000	10378	8184	79	-2194
2	Taksë mbi truallin	1700	1418	1235	87	-183
3	Tatim I thjeshtuar mbi fitimin	0	0	39		39
4	Takse e ndik.infr.nd.reja dhe legalizimet	7000	5650	4536	80	-1114
5	Takse mbi kalimin e te drejtes se prones.	500	500	96	19	-404
6	Takse Rregjistrim automjeti	6000	4842	4132	85	-710
7	Takse Tabele	400	400	404	101	4
8	Taksë mbi token bujqësore	2025	1575	1675	106	100
9	Taksë fjetje në hotel	500	500	148	30	-352
10	Tatim mbi të ardhurat personale	4500	2493	2378	95	-115
11	Takse shitje pasuri e paluajteshme	0	0	8		8
B	TE ARDHURA JOTATIMORE	40240	31904	29107	91	-2797
1	Tarife Pastrimi	13000	10600	12196	115	1596
2	Tarife Ndricimi	7000	5988	3147	53	-2841
3	Tarife Gjelberimi	2000	1679	1924	115	245
4	Leje Rregjistrim Veprimtarie	1800	1350	1410	104	60
5	Qera TOKE BUJQESORE	0	0			0
6	Te ardhura nga kopeshti dhe cerdhja	1500	1125	652	58	-473
7	Tarife Parkimi	500	450	69	15	-381
8	Tarifë për lëndë drusore	1100	450	1001	222	551
9	Tarifë zënie hapësirë publike	1200	990	1471	149	481
10	Tarifë kullotje bagëtije	2500	2000	1152	58	-848
11	Tarifë mirëmbajtje kanale vaditës	600	490	132	27	-358
12	Të ardhura nga ndermarret dhe pronesia	6540	4462	2402	54	-2060
13	Tarifa vendore nga urbanistika	1500	1500	3023	202	1523
14	Tarifa shërbimesh të MNZ	500	420	47	11	-373
15	Certifikate perdorimi	0	0	186	0	-186
16	Te tjera te ardhura	500	400	295	74	-105
17	Total Tatimore +Jotatimore	74865	59660	51942	87	
18	Tarife vendore per uje			0		
20	sekuestrime e gjoba			541		
21	sponsorizime			838		
	Të ardhura viti 2025	74865	59660	53321	89.4	6339
	VITI 2024			41191	133	12130

Realizimi i të ardhurave për periudhën raportuese Janar- Gusht viti 2025, siç shihet dhe nga tabela e mësipërme është në vlerën 53,321,000 lekë ose 6,339,000 lekë më pak se plani i periudhës raportuese.

I shprehur në përqindje ky realizim krahasuar me planin 8- mujor është 89.4%


Po paraqesim grafikisht realizimin e të ardhurave për 8-mujorin 2025.






Të ardhurat në periudhën Janar -Gusht viti 2025 janë realizuar në vlerën 53,321,000 leke .Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar janë gumbulluar 12,130,000 lekë më shumë.Rritja më e madhe ishte te taksa e pasurisë,taksa e ndikimit në infrastrukturë,tarifa vendore e urbanistikeë,tarifa e pastrimit etj.Grafikisht krahasimi i realizimit të ardhurave për vitet 2024-2025 paraqitet si më poshtë :





Nga Sektori i Tatim Taksave, Aseteve dhe Licencave është punuar maksimalisht për realizimin e të ardhurave të periudhës raportuese dhe njëkohësisht për të grumbulluar të ardhura nga detyrimet e prapambetura për të ulur borxhin tatimor. Janë ndjekur të gjitha fazat e njoftimeve dhe rinjoftimeve konform ligjit 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar . Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurta Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimi nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurta Tatimore", kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor". E rëndësishme të thuhet në këtë raportim është rritja e vjeljes së taksës së pasurisë në periudhën raportuese krahasuar me vitin 2024, gjë që ndikonte në vlerësimin e performancës së Bashkisë Përmet.





Në vitin 2024 Taksa e Pasurisë ishte realizuar në periudhën 8 mujore 7,202,000 lekë ,kurse në të njëjtën periudhë të këtij viti është realizuar 11,094,000 lekë.

Gjatë kësaj periudhe është bashkëpunuar me Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve Gjirokastrë si Agjent Tatimor, për derdhjen në kohë të të ardhurave të grumbulluara nga popullata .Detyrimi vjetor i të ardhurave për popullatën është shpërndarë në 10 muaj.



DERDHJET UJESJELLES 2025													
NR	DATA	NDERTESA	DRUTE	UJI	NDRICIM	PASTRIMI	GJELBERI	TRUALLI	TOKA	PASTRIMI	TOTAL DERDHJE	ARKETIM	3%
1. Nentor 2024	14.01.2025	1188892	190013	100133	214540						1693578	1745956.56	52378.7
2. Dhjetor 2024	05.02.2025	671493	165978	7557		211614	66119	153059	229004	616098	2120922	2186517.83	65595.5
3. Janar 2025	04.03.2025	641046	152156	6868	67414	181774	32440	24249	209565		1315512	1356197.87	40685.87
4. Shkurt 2025	04.04.2025	118407	14842	973	23508	46664	14300	7699	34232		260625	268684.69	8059.69
5. Mars 2025	09.05.2025	42139	6691	448	11356	31781	5573	1664	8990		108642	112002	3360
6. Mars 2025	22.05.2025	343643	64718	6790	170516	496313	39063	23581	92498		1237122	1275383.9	38261
7. Prill 2025		371438	75884	7692	198680	563856	66494	4400	106766		1395210	1438360.98	43150.8
8. Maj 2025	06.08.2025	370072	83690	8391	203332	556084	60989	4395	115174		1402127	1445511	43365.33
9. qershor	26.08.2025	384667	77726	7934	211748	605261	56751	5085	112932		1462104	1507424	45223
TOTAL		4131797	831698	146786	1101094	2693347	341729	224132	909161	616098	10995842	11336038.8	340079.9

Plani për periudhën raportuese është 7,403,565 lekë ,fakti 6,012,880 lekë .Në realizim nuk është përfshirë derdhja e muajit Korrik rreth 1,400,000 lekë e cila do na derdhet këto ditë.

Në realizimin e të ardhurave në tabelë janë përfshirë realizimi i periudhës Nëntor-Dhjetor viti 2024,të cilat janë derdhur gjatë muajit Janar dhe Shkurt 2025.

E gjithë vëmendja e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik ,Bujqësisë dhe Turizmit në këtë periudhë është përqëndruar në mbledhjen e detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitorë ndër vite,me qëllim uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e përfomancës së Bashkisë.

.Janë ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm për njoftimin dhe rinjoftimin e subjekteve, konform Ligjit nr.9920,datë 19.05.2008”Për procedurta Tatimore në Republikën e Shqipërisë”,Udhëzimi nr.24,datë 02.09.2008 ”Për procedurta Tatimore “,kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor”.

Për periudhën që raportojmë kanë shlyer detyrimet e prapambetura,rreth 25 subjekte, në vlerën 1,160,984 lekë.

REALIZIMI I BUXHETIT PËR 8 M E VITIT 2025

Buxheti vjetor për vitin 2025 është në shumën 557,837 mijë lekë. Për periudhën janar–gusht, planifikimi i shpenzimeve ishte 155,941 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik i shpenzimeve rezulton 129,493 mijë lekë, që përbën **83% të planit të kësaj periudhe**. Ky rezultat konsiderohet pozitiv dhe lidhet me disa faktorë kryesorë. Së pari, fondet janë përdorur më me kujdes në sektorët prioritarë, duke siguruar një shpërndarje më efektive të shpenzimeve. Së dyti, menaxhimi i



procedurave të prokurimit publik ka qenë më i rregullt, duke bërë të mundur që procedurat të realizohen me sukses. Gjithashtu, planifikimi I miratuar për tetëmujorin e parë ka ndikuar në një ritëm më të qëndrueshëm dhe pozitiv. Këta faktorë kanë ndikuar që realizimi i buxhetit të jetë në nivel të kënaqshëm dhe të krijojë bazë të fortë për vijimin e vitit.

Paraqitja e realizimit të shpenzimeve për periudhën tetëmujore të vitit pasqyrohet si më poshtë:


Nr	Struktura	Plani vjetor	Fakti 8 Mujor
1	Aparati I Bashkise (AA135)	79139671	38741233
	Total AA 135	79139671	38741233
1	Bordi I kullimit 4240	20581415	5120197
2	Sherbimi pyjor 4260	13110605	6537956
3	Rruget rurale 4520	38292822	14064736
4	Pastrim 5100	52507861	12196949
5	Gjelberim ,Brigada 6260	45500120	23178261
6	Planifikim Territorit 6140	0	0
	Total AB 135	169992823	61098099
1	Arsimi (00.09120.01)	42247000	23738062
2	Konvikti(00.9230.01)	12405715	3954389
3	Shk.Mesme(00.9230.01)	7149836	3071554
4	Cerdhja (00.10430.01)	7016000	3606672
5	Perfshirje (00.10430.01)	10399000	6162732
6	KEY PEOPLE KEY (00.10430.01)	1488000	992352
7	RIËET (00.10430.01)	6012000	5211150
	Total AC 135	86717551	46736911
1	Kultura (00.08220.01)	16940634	10232075
2	Sporti 00.8130.1	29885387	14827604
3	ARCH 8220	2051000	1907421
	Total AD 135	48877021	26967100
1	Zjarrfikset 3280	33946426	16247108
2	Policia 3140	6549000	4172089
	Total AE 135	40495426	20419197
1	Fond rezerve 4940	4131000	702000
2	Fond emergjence	0	0
3	Transferime Keshillit te Qarkut 0.4980.01	0	0
	Total AF 135	4131000	702000



	TOTALI KAP 1	429353492	194664540
1	6260.2 AB135	-	-
2	8220.2 AD135 URBACT	3,557,000	-
3	8220.2 AD135 EURBAN DECO	1,410,000	950205
4	10430.2 AC135 RIËET	3,505,000	-
5	AC135 06	1,537,000	1223071
	TOTAL KAP 2 skeme e plote thesari	10,009,000	2173276
1	Aparati I Bashkise (AA135)	28113273	17782691
	Total AA 135	28113273	17782691
1	Bordi I kullimit 4240.05	2000000	444711
2	Sherbimi pyjor 4260.05	0	0
3	Rruget rurale 4520.05	31514000	932521
4	5100 Pastrim	5000000	4120423
5	6260 Gjelberim ,Brigada	14000000	5795735
	Total AB 135	52514000	11293390
1	Arsimi (00.09120.05)	20642000	5074206
2	Konvikti I Shk.Mesme(00.9230.05)	0	0
3	10430,05	8106305	568000
	Total AC 135	28748305	5642206
1	8220.5	2500000	2000000
2	Sporti 00.8130.5	5898613	723246
	Total AD 135	8398613	2723246
1	Fond rezerve 4940.05	700000	380000
2	Fond emergjence	0	0
	Total AF 135	700000	380000
	TOTALI KAP 5	118,474,191	37,821,533
	TOTALI	557,836,683	234,659,349

Plani dhe realizimi i shpenzimeve të paraqitura në tabelën e mësipërme janë rakorduar me Degën e Thesarit. Realizimi i shpenzimeve për periudhën tetë mujore është mbuluar nga të ardhurat e Bashkisë, të cilat janë pasqyruar në tabelën e fondeve për kapitullin 05, si dhe nga fondet e siguruar përmes Transferteve të pakushtëzuara dhe transfertave të kushtëzuara sektoriale, të cilat janë reflektuar në kapitullin 01 të tabelës së fondeve. Me siper pasqyrohen dhe fondet me kapitull 02 me skemë të plotë thesari. Në këtë periudhë, realizimi i shpenzimeve ka arritur në nivelin 42% në raport me planin vjetor dhe 83 % në krahasim me planin për periudhën raportuese.





1. Programi AA135 "Planifikim dhe menaxhim"

Ky program mbulon funksionin bazë dhe mbështetës të administratës së bashkisë, duke përfshirë strukturat që sigurojnë organizimin, ndjekjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së përditshme institucionale. Ai përfshin gjithashtu veprimtarinë e këshillit bashkiak, trajnimet e stafit dhe çështje që lidhen me detyrime ligjore apo administrative.

Realizimi i shpenzimeve për tetëmujorin e vitit 2025 për këtë program përfaqëson 53% të planifikimit total vjetor. Në analizë krahasuese me planin e tetëmujorit, realizimi sipas zërave kryesorë paraqitet si më poshtë:

- ✓ shpenzimet korrente janë realizuar në masën 75% ndaj buxhetit të planifikuar për tetëmujorin e parë
- ✓ shpenzimet kapitale rezultojnë në një nivel minimal prej vetëm 0.1 %.

Ky tregues evidenton një ritëm shumë të ulët të realizimit të investimeve të planifikuara për këtë periudhë. Në përfundim, edhe pse ka një ecuri të mirë në shpenzimet korrente dhe realizimin e aktiviteteve operationale, ritmi i ulët në zbatimin e shpenzimeve kapitale mbetet një sfidë që kërkon ndërhyrje për të siguruar realizimin e plotë të objektivave të këtij programi deri në fund të vitit.

Për vitin 2025, janë parashikuar 3 produkte në këtë program, të cilat rezultojnë të realizuara si më poshtë.

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2025 në mijë lekë	Buxheti 8 mujor i parë	Realizimi faktik i 8- mujorit të parë 2025		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Kapacitetet menaxhuese dhe implementuese të institucioneve të trajnuara dhe të mirëfunksionuara për hartimin dhe monitorimin e politikave.	80,863	53,997	46,927	87	pjesërisht
Shpenzime kapitale	4,545	4,545	82	2	pjesërisht
Procedura pune të realizuara, materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre, shpenzime transporti, udhëtimi brenda dhe jashtë vendit, si dhe shpenzime të tjera operative, në funksion të aktiviteteve të institucionit.	21,845	16,877	9,515	56	pjesërisht
TOTALI	107,253	75,419	56,524	75	

Siç paraqitet në tabelë, ky program përfshin tre produkte kryesore: pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit të Bashkisë, shpenzimet e përgjithshme operative dhe shpenzimet kapitale. Realizimi i shpenzimeve për secilin prej këtyre produkteve është rakorduar me Degën e Thesarit Përmet. Niveli i realizimit për këtë tetëmujor është rezultat i planifikimit të mirë të fondeve.



2- Programi AB135 "Shërbime Publike Komunitare dhe Infrastruktura"

Politikat në fushën e zhvillimit të komunitetit kanë konsistuar kryesisht në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e hapësirave publike dhe mjediseve të përbashkëta. Aktivitetet kanë përfshirë gjelbërimin e ambienteve publike, mirëmbajtjen e varrezave, parqeve, lulishteve dhe fidanishtes, si dhe zëvendësimin e trotuareve të dëmtuara. Gjithashtu, është vijuar me ndriçimin e hapësirave publike, dhënien e lejeve të zhvillimit, planifikimin e territorit, si dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore urbane dhe rurale. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe mirëmbajtjes së sistemeve të ujitjes dhe kullimit, menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, si dhe menaxhimit të mbetjeve urbane dhe rurale.

Për periudhën tetë mujore të vitit 2025, realizimi i buxhetit për këtë program për produktet e planifikuara paraqitet në nivelin 33% të totalit të planifikuar vjetor. Në analizë me planin e tetëmujorit, realizimi sipas zërave kryesorë evidentohet si më poshtë:

- ✓ shpenzimet korrente janë realizuar në masën 40 %
- ✓ shpenzimet kapitale rezultojnë në një nivel minimal prej vetëm 1%

Ky rezultat tregon një ritëm të ngadaltë në zbatimin e komponentëve të investimeve, ndërkohë që shpenzimet korrente paraqesin një nivel të moderuar realizimi për këtë periudhë.

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2025 në mijë lekë	Realizimi faktik i 8- mujorit 2025			
		Buxheti 8 mujor	Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimi
Paga e sig.shoqërore	107,865	81,137	61,146	75	pjeserish
Shpenzime kapitale	86,326	75,061	1,085	1	pjeserish
Procedura pune te realizuara / Materiale dhe shërbime te pergjitheshme zyre, shpenzime transporti, dhe te tjera operativeper mirembajtje ne funksion te aktiviteteve te institucionit.	28,316	22,160	10,161	46	pjeserish
TOTALI	222,507	178,358	72,392	41	



Pjesë e Programit AB 135 janë pesë funksione kryesore, të cilat përfaqësojnë fusha të rëndësishme ndërhyrjeje në mbështetje të komuniteteve dhe zhvillimit të qëndrueshëm vendor. Në vijim, secili prej këtyre funksioneve do të analizohet në mënyrë të veçantë në këtë raport, në funksion të vlerësimit të realizimit buxhetor dhe ndikimit të tyre konkret në përmirësimin e shërbimeve dhe infrastrukturës në njësitë përkatëse.

- ❖ **Funksioni “Rrjeti rrugor rural”** si pjesë e programit AB135 synon mirëmbajtjen, ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve dhe urave në zonat rurale, me qëllim përmirësimin e aksesit dhe mbështetjen e komuniteteve lokale. Ky funksion kontribuon drejtpërdrejt në lehtësimin e lëvizjes, zhvillimin ekonomik dhe lidhjen më të mirë të zonave të thella me qendrat urbane.

Për periudhën tetëmuajore të vitit 2025, realizimi i buxhetit për këtë program për produktet e planifikuara paraqitet në nivelin 21.4 % të totalit të planifikuar vjetor. Në analizë me planin e tetëmuajorit, realizimi sipas zërave kryesorë evidentohet si më poshtë:

- ✓ **shpenzimet korrente janë realizuar në masën 26%**

mijë lekë

Produkti	Buxhëti 2025 në mijë lekë	Realizimi faktik i 8- mujorit 2025			
		Buxheti 8 mujo	Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimi
Paga e sig.shoqërore	22,550	15,561	13,690	88	pjeserish
Shpenzime kapitale	43,968	39,083	0	0	pjeserish
Procedura pune te realizuara / Materiale dhe sherbime te pergjitheshme zyre, shpenzime trasporti, dhe te tjera operativeper mirembajtje ne funksion te aktiviteteteve te institucionit.	3,288	2,688	1,307	48.6	pjeserish
TOTALI	69,806	57,332	14,997	26	

- ❖ **Funksioni “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”** ka si qëllim mirëmbajtjen, administrimin dhe funksionimin e qëndrueshëm të rrjeteve ujitëse dhe kulluese në territorin e Bashkisë. Ky funksion synon të sigurojë përmirësimin e kushteve për aktivitetin bujqësor, parandalimin e përmytjeve dhe rritjen e



eficiencës në përdorimin e burimeve ujore. Ndërhyrjet përfshijnë pastrimin e kanaleve, rehabilitimin e segmenteve të dëmtuara dhe monitorimin periodik të rrjetit, në funksion të përmirësimit të shërbimeve ndaj komunitetit .

Realizimi i shpenzimeve për funksionin “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit” gjatë tetëmuorit të parë të vitit 2025 paraqitet në nivelin 25 % të buxhetit vjetor të planifikuar për këtë funksion. Në raport me planin vjetor dhe 8-mujor, realizimi sipas zërave kryesorë financiare rezulton si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2025 në mijë lekë	Buxheti 8 mujor	Realizimi faktik i 8- muorit 2025		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimi
Paga e sig.shoqërore	10,048	8,194	3,164	39	pjeserisht
Shpenzime kapitale	7,478	7,478	894	12	
Procedura pune te realizuara ne funksion te aktiviteve te institucionit.	5,055	3,895	1,507	39	pjeserish
TOTALI	22,581	19,567	5,565	28	

Siç pasqyrohet edhe në tabelë, ky funksion përfshin tre produkte kryesore: pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e Bordit të Kullimit, si dhe shpenzime kapitale që lidhen me blerjen e mjetit dhe proceset teknike të projekteve të tilla si kanali ujitës Buhal dhe rezervuari Qilarisht, të cilat përfshijnë oponencën teknike, vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM), supervizimin, kolaudimin, etj. Realizimi financiar i të tre produkteve është rakorduar me Degën e Thesarit Përmet, duke garantuar përputhje të plotë me procedurat buxhetore të zbatimit.

- ❖ Funksioni i “Menaxhimit të mbetjeve” ka për qëllim organizimin, kontrollin dhe përmirësimin e shërbimeve të pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e Bashkisë, përfshirë zonat urbane dhe rurale. Një fokus i veçantë i është kushtuar zonave përgjatë luginës së lumit Vjosë, si dhe vendbanimeve rurale me vlera të larta turistike, të cilat tërheqin vizitorë gjatë gjithë vitit. Ky funksion synon të sigurojë një mjedis të pastër, të qëndrueshëm dhe mikpritës, duke kontribuar në



ruajtjen e potencialit natyror dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm. Aktivitetet përfshijnë grumbullimin e mbetjeve, transportin, depozitimin në vende të miratuara, pastrimin periodik të zonave të ndjeshme dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve.

Realizimi i shpenzimeve për funksionin “Menaxhimi i mbetjeve” gjatë tetëmuajorit të parë të vitit 2025 përfaqëson rreth 28 % të buxhetit vjetor të planifikuar për këtë funksion nga Bashkia. Në analizë me planin vjetor dhe planin 8-mujor, realizimi sipas zërave kryesorë të shpenzimeve paraqitet si më poshtë:

Produkti	Buxheti 2025 në mijë lekë	Buxheti 8 mujor	mijë lekë Realizimi faktik i 8- muajorit 2025		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimi
Paga e sig.shoqerore	24,662	17,310	14,611	84	pjeserish
Shpenzime kapitale	24,252	17,872	147	0.8	pjeserish
Procedura pune te realizuara , ne funksion te aktiviteve te institucionit.	8,594	6,703	1,560	23	pjeserish
TOTALI	57,508	41,885	16,318	39	

Siç pasqyrohet edhe në tabelë, ky funksion përfshin dy produkte kryesore: pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e angazhuar në menaxhimin e mbetjeve, si dhe shpenzimet që lidhen me funksionimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të përdorura në këtë sektor. Investimet e planifikuara në funksionin e menaxhimit të mbetjeve për vitin 2025 synojnë përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e eficiencës së këtij shërbimi. Ndër ndërhyrjet e parashikuara përfshihet blerja e mjeteve për transportin e mbetjeve, kontenierëve dhe koshave të rinj për depozitimin e tyre, me qëllim mbulimin më të mirë të territorit dhe përmirësimin e standardeve të pastrimit. Gjithashtu, janë parashikuar procedura të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe oponencës teknike për ngritjen e Qendrës Burimore të Mbetjeve në Përmet, si dhe ndërhyrje për sistemimin dhe pyllëzimin e venddepozitimeve ekzistuese, me synim rehabilitimin mjedisor dhe reduktimin e ndotjes. Këto investime përbëjnë një hap konkret drejt menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit. Realizimi financiar për të dy produktet është rakorduar me Degën e Thesarit Përmet, duke siguruar përputhshmëri të plotë me procedurat zyrtare të zbatimit buxhetor.

❖ **Funksioni i “Administrimit të pyjeve dhe kullotave” përfshin një gamë të gjerë**



kullosore në administrim të Bashkisë. Qëllimi i këtij funksioni është ruajtja, zhvillimi dhe rigjenerimi i ekosistemeve pyjore dhe kullosore, duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e klimës lokale dhe forcimin e qëndrueshmërisë natyrore të territorit. Aktivitetet përfshijnë zbatimin e planeve të menaxhimit për pyjet dhe kullotat, rigjenerimin natyror dhe artificial të pyjeve, pyllëzime në sipërfaqe të degraduara, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve pyjore dhe parcelave kullosore, si dhe ndërhyrje të tjera për mbrojtjen nga erozioni dhe zjarret. Ky funksion ka rëndësi të veçantë edhe për zhvillimin rural dhe promovimin e ekoturizmit në zonat me potencial natyror.

Realizimi i shpenzimeve të 8-mujorit të parë të vitit 2025, për këtë funksion, përfaqëson rreth 50 përqind të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2025 në mijë lekë	Buxheti 8 mujor	Realizimi faktik i 8- mujorit 2025		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi realizim
Paga e sig.shoqërore	10,663	8,262	6,330	77	pjeseris
Shpenzime kapitale	0	0	0	0	
Procedura pune të realizuara / Materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre, shpenzime transporti, udhëtimi brenda dhe jashtë vendit dhe të tjera operative, në funksion të aktiviteteve të institucionit	2,448	2448	208	8	pjeseris
TOTALI	13,111	10,710	6,538	61	

Siç pasqyrohet edhe në tabelë, ky funksion përfshin tre produkte kryesore: pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e Bashkisë, si dhe shpenzime të tjera të përgjithshme që lidhen me funksionimin administrativ të këtij sektori. Realizimi financiar për të gjitha produktet është rakorduar me Degën e Thesarit Përmes, duke garantuar përputhshmëri të plotë me procedurat buxhetore dhe transparencën në zbatimin e fondeve.

❖ Funksioni i “Shërbimeve publike vendore” përfshin një sërë aktiviteteve të



rëndësishme që kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe në krijimin e një mjedisi urban të pastër, funksional dhe estetikisht të këndshëm. Ky funksion mbulon mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra, lulishteve dhe parqeve publike, duke garantuar pastërtinë, rigjenerimin e bimësisë dhe shtimin e hapësirave të gjelbra. Po ashtu, përfshin shërbimin e ndriçimit publik në rrugë dhe sheshe, duke siguruar siguri dhe funksionalitet në jetën e përditshme të komunitetit. Një komponent tjetër i rëndësishëm është mirëmbajtja e infrastrukturës urbane si sheshet, trotualet dhe varrezat publike, të cilat kërkojnë ndërhyrje të vazhdueshme për të ruajtur standardin urban dhe respektin ndaj hapësirave të përbashkëta. Ky funksion luan një rol kyç në estetikën dhe funksionimin e qytetit, veçanërisht në zona me frekuentim të lartë publik dhe turistik.

Realizimi i shpenzimeve të 8-mujorit të parë të vitit 2025, për këtë funksion, përfaqëson rreth 48.6 përqind të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të, krahasuar me planin vjetor dhe atë 8-mujor rezulton si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2025 në mijë lekë	Buxheti 8 mujor	Realizimi faktik i 8- mujorit. 2025		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi realizim
Paga e sig.shoqerore	39,942	31,810	23,351	73	pjeserish
Shpenzime kapitale	10,628	10,628	44	0.41	
Procedura pune të realizuara / Materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre, shpenzime transporti, udhëtimi brenda dhe jashtë vendit dhe të tjera operative, në funksion të aktiviteteve të institucionit	8,931	6,426	5,579	87	pjeserish
TOTALI	59,501	48,864	28,974	59	



Siç pasqyrohet edhe në tabelë, ky program përfshin tre produkte kryesore, që lidhen kryesisht me pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit të Bashkisë, si dhe me shpenzime të tjera të përgjithshme të nevojshme për funksionimin e shërbimeve publike. Realizimi financiar i këtyre produkteve është rakorduar plotësisht me Degën e Thesarit Përmet, duke reflektuar zbatim të rregullt dhe në përputhje me planifikimin buxhetor.

3- Programi AC135 "Arsimi dhe kujdesi social".

Ky program synon mbështetjen e arsimit parashkollor dhe arsimit bazë, si dhe administrimin dhe rregullimin efektiv të sistemit arsimor në njësitë përkatëse. Gjatë kësaj periudhe 8-mujore është ndjekur zbatimi i masave për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në kopshtet dhe çerdhet publike, përforcimi i kujdesit social në qendrat sociale dhe konviktet, si edhe garantimi i një mjedisi të sigurt dhe gjithëpërfshirës për fëmijët dhe përfituesit e tjerë të këtyre shërbimeve.

Realizimi i shpenzimeve të 8-mujorit të parë të vitit 2025, për këtë funksion, përfaqëson rreth 44.4 **përqind** të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Sipas zërave kryesorë të realizuar në 8 muor ,krahasuar me planin 8- muor, rezultojnë si më poshtë:

Shpenzimet korente 54 përqind

Realizimi sipas produkteve:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2025 në mijë lekë	Buxheti 8 muor	Realizimi faktik i 8- muor 2025		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi realizim
Paga e sig.shoqërore	64,315	42,725	40,704	95	pjeseris
Shpenzime kapitale	31,857	28,710	5,074	18	pjeseris
Procedura pune të realizuara, në funksion të aktiviteteve të institucionit	24336	19051	7,824	41	pjeseris
TOTALI	120,508	90,486	53,602	59	



Sikurse pasqyrohet edhe në tabelën përkatëse, ky program ofron tre produkte kryesore. Produktet përfshijnë pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin që operon në funksion të këtij programi pranë Bashkisë, si dhe shpenzimet e tjera të përgjithshme, ku përfshihen kostot për energjinë elektrike, ujin, materialet e kancelarisë dhe pastrimit (detergjentë). Gjithashtu, janë përfshirë edhe shpenzimet për mbështetje sociale, konkretisht pagesat e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë dhe kompensimi me bonus qiraje për këtë kategori. Të gjitha të dhënat financiare dhe shpenzimet e lidhura me këto produkte janë rakorduar dhe konfirmuar nga Degë e Thesarit Përmet.

Pjesë e Programit AC135 janë tre funksione kryesore, të cilat përfaqësojnë shtyllat themelore të ofrimit të shërbimeve në fushën e arsimit, kujdesit social dhe mbështetjes për shtresat në nevojë. Këto funksione lidhen ngushtësisht me garantimin e aksesit në arsim cilësor dhe shërbime sociale të standardizuara, si dhe me sigurimin e një mbështetjeje efektive për familjet e cënueshme.

Në vijim të këtij raporti, secili prej funksioneve do të trajtohet veçmas, me qëllim vlerësimin e realizimit buxhetor dhe analizimin e ndikimit të tyre konkret në përmirësimin e jetës së përditshme të qytetarëve në njësitë përkatëse të Bashkisë.

- ❖ **Funksioni "Arsimi bazë dhe parashkollor"** përfshin mbështetjen institucionale dhe financiare për sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë, me qëllim garantimin e një mjedisi mësimor cilësor, të sigurt dhe gjithëpërfshirës për fëmijët e moshave përkatëse. Ky funksion përfshin sigurimin e bazës materiale të nevojshme për funksionimin efikas të institucioneve arsimore, përfshirë shkollat dhe kopshtet, furnizimin me mjetë didaktike, përmirësimin e infrastrukturës, si dhe mbulimin e shpenzimeve për ushqimin ditor në kopshtet që ofrojnë shërbim me drekë.

Gjatë tetëmuorit të parë të vitit 2025, realizimi i shpenzimeve për funksionin "Arsimi bazë dhe parashkollor" ka arritur në 46% të buxhetit të planifikuar vjetor, duke treguar një ritëm të moderuar të zbatimit të buxhetit në këtë periudhë.

Analiza e realizimit të shpenzimeve sipas zërave kryesorë tregon një shpërndarje të ndryshme të fondeve në përputhje me prioritetet dhe nevojat e paraqitura, krahasuar me planin vjetor. Detajimi i shpenzimeve sipas kategorive specifike të funksionit paraqitet si më poshtë:

Produkti	Buxheti 2025 në mije lekë	Buxheti 8 mujo	Realizimi faktik i 8- muorit 2025		
			Në Mije lekë	Në %	Statusi i realizimi
Paga e sig.shoqërore	34,889	23,280	22,189	95	pjeserish
Shpenzime kapitale	20,127	20,127	5,074	25	



Procedura pune te realizuara, ne funksion te aktiviteve te institucionit	7,873	6,016	1,549	26	pjeserisht
TOTALI	62,889	49,423	28,812	58	

Siç evidentohet edhe nga tabela përkatëse, programi “Arsimi bazë dhe parashkollor” përqendrohet në tre produkte kryesore, të cilat përbëjnë bazën funksionale të shpenzimeve të realizuara gjatë tetëmuorit të parë të vitit 2025. Produkti kryesor lidhet me pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin edukativ të kopshteve, që operojnë si në qytetin e Përmetit, ashtu edhe në njësitë administrative përreth. Ky zë përfaqëson një përqindje të konsiderueshme të buxhetit dhe është i domosdoshëm për garantimin e mbarëvajtjes së procesit edukativ në institucionet parashkollore.

❖ **Funksioni “Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm”**

Ky funksion përfshin mbështetjen për institucionet e arsimit të mesëm si dhe për konviktin e qytetit, me qëllim garantimin e një mjedisi funksional dhe dinjitoz për nxënësit. Në kuadër të këtij funksioni janë siguruar bazat materiale të nevojshme për funksionimin e rregullt të shkollave dhe konviktit, furnizimi me ushqime për konviktorët si dhe përmirësimi i kushteve të jetesës në ambientet konvikto-re, me synimin për të krijuar një hapësirë të përshtatshme dhe mbështetëse për të rinjtë që ndjekin arsimin e mesëm larg vendbanimit të tyre.

Realizimi i shpenzimeve të 8-mujorit të parë të vitit 2025, për këtë funksion, përfaqëson rreth 36 përqind të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie.

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të krahasuar me planin 8 mujor rezulton si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2025 në mijë lekë	Buxheti 8 mujor	Realizimi faktik i 8- muorit 2025		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqerore	9,771	6,698	6,260	93	pjeserisht



Shpenzime kapitale	6,026	2,879	0	0	
Procedura pune te realizuara / Materiale dhe sherbime te pergjitheshme zyre, shpenzime trasporti, udhetimi brenda dhe jashte vendit dhe te tjera operative, ne	3,759	2,969	766	26	pjeserisht
TOTALI	19,556	12,546	6,996	56	

Sikurse pasqyrohet edhe në tabelën përkatëse, ky program përfshin tre produkte kryesore, të cilat lidhen ngushtësisht me funksionimin dhe mbështetjen e institucioneve të arsimit parashkollor. Produktet përfshijnë, së pari, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e edukatoreve që operojnë në kopshtet e qytetit dhe në njësitë administrative. Së dyti, përfshihen shpenzimet e tjera të përgjithshme, të cilat mbulojnë furnizimin e institucioneve me bazë materiale si kancelari dhe detergjentë, për të garantuar ambiente mësimore të mirëmbajtura dhe funksionale. Po ashtu, përfshihen edhe pagesat për energjinë elektrike dhe ujin, si dhe kostot për ushqimin e fëmijëve në kopshtet që ofrojnë shërbim dreke.

Të gjitha këto shpenzime dhe produkte janë rakorduar dhe verifikuar në bashkëpunim me Degën e Thesarit Përmet, duke siguruar përputhshmëri të plotë me kuadrin buxhetor dhe transparencën institucionale.

- ❖ **Funksioni “Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijët”**
Ky funksion synon ofrimin e një mbështetjeje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për shtresat më të ndjeshme të shoqërisë, në veçanti për fëmijët dhe familjet në nevojë. Në këtë kuadër, sigurohet baza materiale dhe logjistike për funksionimin e strukturave të kujdesit social, si çerdhet, qendrat sociale dhe njësitë e tjera që ofrojnë shërbime për komunitetin. Mbështetja përfshin furnizimin me ushqime, përkujdesjen nga personeli edukativ dhe ndihmës, si dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e fëmijëve në mjedise të sigurt dhe të stimuluar. Gjithashtu, në kuadër të këtij funksioni është përfshirë edhe implementimi i projekteve sociale me ndikim të drejtpërdrejtë në komunitet, si p.sh. projekti Key People, projekti synon krijimin e mundësive të reja për punësim dhe ndërmarrje për gratë dhe të rinjtë e papunë, duke reduktuar pabarazitë dhe duke mbështetur lidhshimin femëror në sipërmarrje dhe vetëpunësim. Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve synohet rritja e aksesit në shërbime sociale, përmirësimi i mbrojtjes së fëmijëve dhe promovimi i përfshirjes sociale në nivel vendor.

Realizimi i shpenzimeve të 8-mujorit të parë të vitit 2025, për këtë funksion, përfaqëson rreth 47 përqind të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të krahasuar me planin vjetor dhe 8-mujor rezulton si më poshtë:



Produkti	Buxheti 2025 në mijë lekë	Buxheti 8 mujor	Realizimi faktik i 8- mujorit 2025		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqërore	19,655	12,747	12,255	96	pjeserisht
Shpenzime kapitale	5,704	5,704	0	0	.
Procedura pune te realizuara / Materiale dhe shërbime te pergjitheshme zyre, shpenzime transporti, udhëtimi brenda dhe jashte vendit dhe te tjera operative, ne	12,704	10,066	5,509	55	pjeserisht
TOTALI	38,063	28,517	17,764	62	

Sikurse pasqyrohet edhe në tabelën përkatëse, ky program përfshin tre produkte kryesore. Ndër elementët themelorë të tij janë pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit të Bashkisë, si dhe shpenzimet e tjera të përgjithshme që lidhen me funksionimin e institucioneve. Këto përfshijnë kostot për energjinë elektrike, furnizimin me ujë dhe shpenzime të tjera operacionale. Të gjitha produktet dhe zërat e shpenzimeve të këtij programi janë rakorduar dhe verifikuar në bashkëpunim me Degën e Thesarit Përmet, duke garantuar përputhshmëri të plotë me kuadrin buxhetor dhe transparencë financiare.

4- Programi AD135 "Argëtim, Zhvillim dhe Sporte"

Ky program synon nxitjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën kulturore dhe sportive, përmes organizimit dhe mbështetjes së ngjarjeve të ndryshme në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ai përfshin promovimin dhe mbrojtjen aktive të vlerave të trashëgimisë kulturore, si dhe inkurajon zhvillimin e aktiviteteve që forcojnë identitetin lokal dhe kohezionin social. Në kuadër të këtij programi është përfshirë edhe zbatimi i projektit URBACT. Gjithashtu, programi mbështet organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse dhe argëtuese, si dhe menaxhimin dhe funksionimin e institucioneve dhe infrastrukturës që lidhen me këto fusha, me synimin për të nxitur një jetë aktive, pjesëmarrëse dhe të shëndetshme për qytetarët e të gjitha moshave.

.Realizimi i shpenzimeve të 8-mujorit të parë të vitit 2025, për këtë funksion, përfaqëson rreth 49 përqind të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie.



Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë te, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2025 në mijë lekë	Buxheti 8 mujor	Realizimi faktik i 8- mujorit 2025		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqërore	16,131	13,291	10,394	78	pjeserisht
Shpenzime kapitale	30,492	30,492	13,701	45	pjeserisht
Procedura pune te realizuara, ne funksion te aktiviteve te institucionit	15,620	13,907	6,545	47	pjeserisht
TOTALI	62,243	57,690	30,640	53	

Sikurse pasqyrohet edhe në tabelën përkatëse, ky program përfshin tre produkte kryesore. Ndër komponentët themelorë janë pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit të Bashkisë, si dhe shpenzimet e tjera të përgjithshme. Në këtë kategori përfshihen edhe pagesat për ekipet e ndryshme që operojnë në qytet, mbështetur nëpërmjet projektit **RELOAD**, i cili synon forcimin e pjesëmarrjes rinore dhe zhvillimin e aktiviteve komunitare.

Nga ana tjetër, shpenzimet kapitale lidhen me ndërhyrjet në infrastrukturë dhe përfaqësohen nga **Rikonstruksioni i Pallatit të Sportit** në qytet, një investim i rëndësishëm që synon përmirësimin e kushteve për zhvillimin e aktiviteve sportive dhe rritjen e përfshirjes së të rinjve në jetën aktive komunitare.

❖ Funkzioni: Shërbimet Rekreative dhe Sportet

Ky funksion synon nxitjen e pjesëmarrjes aktive të komunitetit në jetën sociale dhe sportive, përmes organizimit të aktiviteve me karakter sportiv, çlodhës dhe argëtues. Ai përfshin gjithashtu zhvillimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e institucioneve dhe objekteve të dedikuara për ushtrimin e këtyre aktiviteve, duke përfshirë fusha sportive, palestra, qendra komunitare dhe ambiente të tjera publike që i shërbejnë aktiviteve të kohës së lirë. Ky funksion përfaqëson një mjet të rëndësishëm për promovimin e një jete aktive, të shëndetshme dhe gjithëpërfshirëse



për qytetarët e të gjitha moshave, si dhe kontribuon në rritjen e ndërveprimit social dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në nivel lokal.

.Realizimi i shpenzimeve të 8-mujorit të parë të vitit 2025, për këtë funksion, përfaqëson rreth **43 përqind** të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2025 në mijë lekë	Buxheti 8 mujor	Realizimi faktik i 8- mujorit 2025		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqërore	0	0	0	0	pjeserisht
Shpenzime kapitale	28,784	28,784	12,553	44	
Procedura pune të realizuara, në funksion të aktiviteteve të institucionit	7,000	7000	2,998	43	pjeserisht
TOTALI	35,784	35,784	15,551	43	

Sikurse pasqyrohet edhe në tabelën përkatëse, ky program përfshin tre produkte kryesore. Elementët kryesorë përbëhen nga shpenzimet e tjera të përgjithshme. Këto përfshijnë pagesat për trajnerët e ekipeve sportive që operojnë në qytet, trajtimin ushqimor për ekipin e futbollit, si dhe dietat për sportistët pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme. Të gjitha produktet dhe zërat përkatës të këtij programi janë rakorduar dhe verifikuar me Degën e Thesarit Përmet, duke siguruar përputhshmëri të plotë me zbatimin buxhetor dhe transparencën financiare.

❖ Funksioni: Argëtim dhe Zhvillim

Ky funksion përfshin organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve kulturore dhe artistike brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes qytetare dhe ruajtjen e identitetit lokal. Në thelb të tij qëndron promovimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore, përfshirë asetet me vlera historike, ndërtimore dhe natyrore, që përbëjnë pasurinë shpirtërore dhe historike të komunitetit. Përmes këtij funksioni synohet jo vetëm gjallërimi i jetës kulturore në nivel vendor, por edhe ndërgjegjësimi i brezave të rinj për rëndësinë e ruajtjes



së vlerave kombëtare dhe lokale, si dhe zhvillimi i potencialit turistik dhe kulturor të zonës.

.Realizimi i shpenzimeve të 8-mujorit të parë të vitit 2025, për këtë funksion, përfaqëson rreth 57 **përqind** të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2025 në mijë lekë	Buxheti 8 mujor	Realizimi faktik i 8- mujorit 2025		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqërore	16,131	13,291	10,394	78	
Shpenzime kapitale	1,708	1,708	1,148	67	
Procedura pune të realizuara, në funksion të aktiviteteve të institucionit	8,620	6,907	3,547	51	pjesërisht
TOTALI	26,459	21,906	15,089	69	

Sikurse paraqitet edhe në tabelën përkatëse, ky program përfshin tre produkte kryesore. Produktet bazë përbëhen nga pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit të Bashkisë, shpenzimet e tjera të përgjithshme, si dhe pagesat e kryera për zërat e investimeve kapitale. Të gjitha shpenzimet dhe produktet që lidhen me këtë program janë rakorduar dhe verifikuar me Degën e Thesarit Përmes, duke siguruar një përputhje të plotë me planifikimin buxhetor dhe zbatimin financiar përkatës.

5- Programi AE135 "Siguria e qytetarit dhe mbrojtja e mjedisit"

Ky program ka në fokus garantimin e sigurisë së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel vendor, përmes një qasjeje të integruar që kombinon ndërhyrjet emergjente, parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve.

Një komponent i rëndësishëm i programit është **garantimi i funksionimit të shërbimit zjarrfikës**, përfshirë administrimin dhe mirëmbajtjen e strukturave përkatëse. Aktivitetet përfshijnë reagimin në kohë ndaj situatave emergjente, **parandalimin dhe luftimin e zjarreve**, si dhe **menaxhimin e**



situatave të rrezikshme që rrjedhin nga fatkeqësi natyrore, aksidente rrugore apo ngjarje të tjera me ndikim në sigurinë publike.

Gjithashtu, programi synon **rritjen e nivelit të sigurisë së qytetarëve** në qytet dhe në njësitë administrative, përmes patrullimeve të vazhdueshme, kontrollit të territorit dhe **mbrojtjes së pronës publike nga dëmtimi, degradimi apo uzurpimi**.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i këtij programi është **ruajtja e mjedisit dhe ndërgjegjësimi i komunitetit**, si pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për zhvillim të qëndrueshëm dhe përmirësim të cilësisë së jetës në territorin e bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve të 8-mujorit të parë të vitit 2025, për këtë funksion, përfaqëson rreth **50.4 përqind** të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2025 në mijë lekë	Buxheti 8 mujor	Realizimi faktik i 8- muorit 2025		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Paga e sig.shoqërore	30,977	20,981	19,460	93	pjeserisht
Shpenzime kapitale	4,136	4,136	0	0	
Procedura pune të realizuara / Materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre, shpenzime transporti,	5,382	5,007	959	19	pjeserisht
TOTALI	40,495	30,124	20,419	68	

Sikurse paraqitet edhe në tabelën përkatëse, ky program përfshin tre produkte kryesore. Ato përbëhen kryesisht nga pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit të Shërbimit Zjarrfikës dhe Policisë Bashkiake, si dhe nga shpenzimet e tjera të përgjithshme për funksionimin e strukturave përkatëse. Në zërin e shpenzimeve kapitale janë përfshirë edhe investimet për pajisjen e institucionit me mjete të nevojshme për përmirësimin e kapaciteteve të punës. Të gjitha produktet dhe shpenzimet e këtij programi janë rakorduar dhe verifikuar me Degën e Thesarit Përmes, duke garantuar transparencë dhe përputhshmëri me planifikimin buxhetor.

6-Programi AF135 “Transferta të individëve, institucione, organizata”

Ky program synon të garantojë mbështetje financiare në raste të situatave të papritura, me qëllim minimizimin e rreziqeve sociale dhe ekonomike që prekin individët, familjet apo institucionet në nivel vendor.

Përmes këtij programi parashikohen **transferta të drejtpërdrejta buxhetore** që shërbejnë si mekanizëm mbështetës për përballimin e **situatave emergjente**, sidomos për **familjet e dëmtuara nga fatkeqësi natyrore, zjarre apo ngjarje të tjera të paparashikuara**. Po ashtu, programi mbulon nevoja të veçanta që nuk janë parashikuar paraprakisht në buxhetin fillestar, duke vepruar si një fond fleksibël për raste të jashtëzakonshme.

Qëllimi kryesor është **zbutja e pasojave sociale dhe ekonomike** për kategoritë më të rrezikuara dhe ndihma në ruajtjen e stabilitetit social në komunitet përmes ndërhyrjeve të shpejta dhe të synuara.

Realizimi i shpenzimeve të 8-mujorit të parë të vitit 2025, për këtë funksion, përfaqëson rreth 22.3 **përqind** të totalit të buxhetit të planifikuar të kësaj bashkie. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë të, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

mijë lekë

Produkti	Buxheti 2025 në mijë lekë	Buxheti 8 mujor	Realizimi faktik i 8- mujorit 2025		
			Në Mijë lekë	Në %	Statusi i realizimi
Paga e sig.shoqërore	0	0	0	0	
Shpenzime kapitale	0	0	0	0	
Procedura pune të realizuara /, në funksion të aktiviteteve të institucionit	4,831	4,075	1,082	27	pjeserish
TOTALI	4,831	4,075	1,082	27	

Në zërin e shpenzimeve të tjera të përgjithshme janë përfshirë pagesat për **transferta të drejtpërdrejta ndaj individëve**, të cilat kanë shërbyer si mbështetje në raste emergjente apo nevoja të papritura sociale. Këto transferta janë realizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në funksion të zbutjes së pasojave nga fatkeqësi të ndryshme. Të gjitha shpenzimet dhe produktet që lidhen me këtë program janë **rakorduar dhe verifikuar me Degën e Thesarit Përmet**, duke garantuar përputhje të plotë me planifikimin dhe disiplinën buxhetore.



Nr	Struktura	Plani vjetor	Fakti
1	Gjendja civile 1170	5,129,054	3,877,464
2	Paaftesia 10430	54,542,998	43,311,245
3	Ndihma ekonomike 10430	4,542,000	3,009,618
4	Projekti i shërbimit social 10430	3,897,262	169,110
5	11.9120.01 .602(Bursa për nxënësit)	329,400	-
6	11.9230.01.231 (Meleq Gosnishti)	60,474,290	60,474,290
7	17.10910.01.231 (Diga Qilarisht)	28,764,388	10,284,923
8	17.10910.01.231(Mjeti zjarrfikës)	6,720,000	-
9	17.10910.01.604(Fond për shtetas të ndihmuar dhe marrje masash parandaluese)	3,838,800	-
10	12.6190.01.606 (Bonus i qirasë)	980,853	256,000
11	12.6190.01.231(Banesat sociale)	6,900,000	-
12	05.4240.01.231 (Kanali Buhal)	23,854,565	23,854,421
13	73.1620.01.602 (KQZ)	1,391,307	1,165,837
	Totali Ministri Linje	201,364,817	146,402,908

Gjatë tetëmuorit të parë të vitit, nga fondet e planifikuara nga ministrinë e linjës në vlerën totale prej **201,364,817 lekësh**, janë realizuar **146,402,908 lekë**, që përbëjnë rreth **73%**.

Në materialin e mësipërm janë paraqitur edhe Projektet me financim të huaj me skemë të plotë thesari si dhe vlerat e bashkëfinancimit tonë.

Më poshtë po trajtojmë çdo projekt më vete duke ju detajuar dhe fondet me skemë të pjesshme thesari.

Në buxhetin e projekteve janë parashikuar shpenzimet e mëposhtme për vitin 2025 :

1. Projekti Key People, Key Knowledge financiar nga Bashkimi Evropian.



Qëllimi i projektit është të krijojë mundësi të reja pune/biznesi për gratë dhe të rinjtë e papunë duke dhënë një alternativë të qëndrueshme ndaj riskut të përfshirjes në kultivimin e kanabisit

Ndërhyrjet kryesore të projektit janë:

- Rikonstruksioni i ambienteve të Ping-Pong në Përmet
- Krijimi i një qendre multifunkionale në Petran.
- Krijimi dhe funksionimi i një inkubatori biznesi
- Rritja e kapaciteteve për start-up dhe mbështetja me grante.

KAPITULL 1					
Key People	Vjetori	8-mujori	Fakt	% 8-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
600	1276	851	850	100%	67%
601	212	152	142	93%	70%

KAPITULL 2 (Skemë e pjesshme thesari)					
Key People	Vjetori	8-mujori	Fakt	% 8-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
602	858	462	287	62%	33%
604 (grante)	827	827	729	88%	88%
231 (kondicioner)	150	150	0	0%	0%

Eshtë bërë rialokim shpenzimesh për kryerjen e eventit final në Tetor 2025

Vlera aktuale e shpenzuar nga bizneset është në masën 80%(nuk u shpenzua granti 100%)

Pagesa është kryer në Dhjetor 2024

2. Projekti SEPAC (Mjedise të Qëndrueshme në Zonat e Mbrojtura për përdorim më të mirë nga qytetarët) financiar nga IADSA.

Objektivi i përgjithshëm është mbështetja për rritjen e turizmit të qëndrueshëm të Bashkive të Përmetit dhe Këlcyrë, nëpërmjet promovimit dhe përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve turistike.

Objektivat specifike janë :

- Të krijojë mundësi punësimi dhe të përmirësojë shërbimet ekzistuese social-kulturore në Bashkitë Përmet dhe Këlcyrë. Ruajtja e trashëgimisë natyrore.
- Të promovojë zgjidhje inovative për zonat e mbrojtura dhe sistemet eko të brishta, të inkurajojë një mjedis të pastër, specie të mbrojtura të kafshëve dhe perimeve dhe akses dhe përdorim më të mirë të tyre nga qytetarët vendas.

Ndërhyrjet kryesore të parashikuar në projekt janë:



-Përmirësimi i infrastrukturës në fshatin Bënjë.

-Përgatitja dhe zbatimi i një plani gjithëpërfshirës të menaxhimit për Ujërat Termale të Bënjës.

-Festivalit i Ditës së Verës në Përmeti si një aktivitet promovues i përvitshëm.

-Ndërtimi i një ballkoni Panoramik.

KAPITULL 2 SKEME E PJESSHME THESARI					
SEPAC	Vjetori	8-mujori	Fakt	% 8-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
230+231	13751	13751	0	0%	0%
604	22534	22534	1900	8%	8%
602	20	10	0	0%	0%

KAPITULL 1					
SEPAC	Vjetori	8-mujori	Fakt	% 8-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
230+231	5187	5187	0	0%	0%

Aktivitetet e parashikuara gjatë kësaj periudhe nuk janë realizuar për arsye se janë kërkuar ndryshime në projekt si zhvendosja nga Ujrat termale në fshatin Bënjë.

3. .Projekti RIËET (Qeverisja publiko-private e lumenjve dhe restaurimi dhe ruajtja e ligatinave si infrastrukturë blu&jeshile)

Bashkia Përmet është një ndër bashkitë e para në Shqipëri që përfiton nga ky program. Në këtë projekt Bashkia do të fokusohet te Lugina e Vjosës. Aktivitetet kryesore janë:

- Organizimi i takimeve periodike me grupet e interesit
- Shkëmbim eksperience nga praktikat e mira të partnerëve
- Pjesëmarrja në të gjitha Webinarët dhe Takimet e Komitetit Drejtues.
- Organizimi i një Workshopi për Shkëmbimin e Përvojave (EEW) në Përmet për të shkëmbyer praktikat e mira mbi bashkëpunimin publik-privat në lidhje me Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Lumit Vjosa dhe angazhimin e komunitetit për mbrojtjen e biodiversitetit dhe natyrës.
- Identifikimi i praktikave të mira që duhen ndarë me partnerët

KAPITULL 1					
RIËET	Vjetori	8-mujori	Fakt	% 8-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
600	3159	2809	2809	100%	89%
601	233	207	207	100%	89%
602	2620	2195	2195	100%	84%



KAPITULL 2 SKEME E PLOTE THESARI					
RIËET	Vjetori	8-mujori	Fakt	% 8-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
600	1755	351	0	0%	0%
601	130	6	0	0%	0%
602	1620	570	0	0%	0%

4. Projekti ARCHETHICS Trashëgimia disonante evropiane si laborator i demokracisë.

Të gjithë partnerët do të angazhohen për të hartuar një plan veprimi të integruar për menaxhimin e trashëgimisë disonante.

Plani do të hartohet nga stafi i projektit me mbështetjen e ekspertëve dhe grupit lokal të veprimit URBACT (ULG). Ky grup ka në përbërje të tij aktorë të ndryshëm të lidhur me tematikën e projektit dhe roli i tyre është shumë i rëndësishëm pasi pjesëmarrja dhe angazhimi i tyre do të ndikojë në hartimin e një plani gjithëpërfshirës dhe efektiv pasi konsideron pikëpamjet e gjithë grupeve të interesit. Në rastin e Bashkisë Përmet, grupet e interesit janë përfaqësues të pushtetit lokal, të institucioneve arsimore, universitetit, të rinj, qytetarë, historianë etj.

Trashëgimia disonante e Përmetit përbën një potencial për zhvillimin e turizmit.

“Trashëgimia disonante” si një burim për turizmin paraqet sfida të reja për institucionet publike dhe operatorët turistikë. Sfida kryesore lidhet me rritjen e “trashëgimisë disonante” si një shtytës i turizmit të qëndrueshëm dhe marketingut territorial. Është e nevojshme të vendoset “trashëgimia disonante” në qendër si një pasuri kulturore parësore për të përfshirë edhe forma të tjera të turizmit në mënyrë të integruar (p.sh. turizmi kulturor, turizmi historik, turizmi i jashtëm dhe i ngadaltë, turizmi i kuzhinës, turizmi mjedisor).

KAPITULL 1					
ARCHETHICS	Vjetori	8-mujori	Fakt	% 8-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
600	1324	1324	1233	93%	93%
601	227	227	223	98%	98%
602	500	500	451	90%	90%
KAPITULL 2 SKEME E PLOTE THESARI					
ARCHETHICS	Vjetori	8-mujori	Fakt	% 8-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
600	945	189	0	0%	0%
601	162	32	0	0%	0%
602	2200	1650	0	0%	0%
230	250	250	0	0%	0%



5. PROJEKTI EURBAN DECO

“Eksplorimi i peisazheve urbane të BE-së për një dekonstrukcion të narrativave koloniale”

Projekti shqyrton trashëgiminë koloniale brenda mjediseve urbane të Evropës. Duke eksploruar simbolet, tregimet dhe toponiminin, ai synon të ekspozojë ndikimin e qëndrueshëm të ideologjive koloniale në qytetet e BE-së. Projekti financohet nga programi i Bashkimit Evropian CERV.

Objektivat:

1. Sensibilizimi mbi marrëdhëniet midis peizazheve urbane, kujtesën historike të së kaluarës koloniale dhe integrimin multikulturor.
2. Ekspozimi i trashëgiminë koloniale brenda mjediseve të qyteteve të BE-së dhe fillimi i një debat kolektiv rreth ndikimit të saj.
3. Nxitja e narrativa të reja dhe përkujtime kulturore të përbashkët me përfshirjen aktive të grupeve të pakicave dhe komuniteteve të emigrantëve.
4. Ngritja e një nisme ndërkombëtare për të tërhequr vëmendje më të gjerë mbi këtë temë nga autoritetet publike dhe palët e interesuara.

Rezultatet e pritshme:

- Një koleksion hartash urbane të rishikuara për 7 qytetet e përfshira në projekt, duke përfshirë referencat kryesore të lidhura me trashëgiminë koloniale dhe duke i riemëruar ato nën perspektivën e popujve të kolonizuar.
- 7 evente ndërkombëtare (secila e fokusuar në një nën-temë specifike të historisë koloniale të BE-së) me një pjesëmarrje të madhe dhe me përfshirjen aktive të grupeve të synuara
- Një nismë ndërkombëtare me qëllim tërheqjen e vëmendjes së politikëbërësve ndaj temës së trashëgimisë koloniale në qytetet e BE-së dhe kërkimi i veprimit kolektiv për ta ri-diskutuar atë.

KAPITULL 2: SKEME E PLOTE THESARI					
EURBAN DECO	Vjetori	8-mujori	Fakt	% 8-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
602	1410	950	950	100%	67%

KAPITULL 1					
EURBAN DECO	Vjetori	8-mujori	Fakt	% 4-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
602	467	270	270	100%	58%

6. Projekti UNDP -së “Të moshuar jo të vetmuar, aktiv dhe të lumtur”



Qëllimi i projektit: Përmirësimi i shërbimeve për moshën e tretë dhe të moshuarit e vetmuar

Objektivat e Projektit: Përmirësimi i kushteve të Qendrës ditore për të moshuarit dhe funksionalizimi i saj

Vlerësimi i nevojave për shërbime ndaj moshës së tretë

Rritja e përfshirjes sociale të moshës së tretë nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të lidhura me këtë kategori

Ofrimi i shërbimit të asistencës shtëpiake, sociale, shëndetësore për të moshuarit e vetmuar

Ndërhyrjet kryesore të parashikuara në projekt janë:

R.1 Mobilimi dhe funksionalizimi i Qendrës ditore për moshën e tretë në qytetin e Përmetit.

- Salla arrehet duke pasur si referencë funksionin e deritanishëm dhe kërkesat e të moshuarve.
- Salla pajiset me pajisjet e nevojshme për kalimin e kohës së lirë

R.2 Realizim i një databaze mbi nevojat e të moshuarve.

- 1 Databazë
- 2 takime me grupet e interesit
- 50 të moshuar të informuar për kontrollet shëndetësore

R.3 Realizim i aktiviteteve që nxisin pjesëmarrjen dhe përfshirjen e moshës së tretë në qytetin e Përmetit.

- Realizimi i eventit “Mirënjohje” 1 Tetori
- Realizimi i Kampionatit të Shahut në qytetin e Përmetit

R4 Ofrimi i shërbimeve në banesë për të moshuarit që jetojnë vetëm pa asnjë të afërm pranë

- Të paktën 16 të moshuar do të përfitojnë nga shërbimi në banesë
- Realizimi i dy trajnimeve nga ekspert i shërbimeve sociale për të moshuarit dhe ofruesit e shërbimeve
- 4 persona të kualifikuar (3 infermierë dhe 1 psikolog) do të ofrojnë shërbime për të moshuarit

KAPITULL 2: SKEME E PLOTE THESARI					
UNDP	Vjetori	8-mujori	Fakt	% 8-MUJORE E REALIZIMIT	% VJETORE E REALIZIMIT
602	1537	1537	1223	80%	80%

Projekti “Të moshuar jo të vetmuar, aktiv dhe të lumtur” ka përfunduar zbatimin në muajin Maj 2025. Projekti parashikonte disbursim të vlerës 1537 nga donatori deri në muajin Maj. Kursimet nga procedurat e prokurimit nuk mund të rialokoheshin ndaj transhi përfundimtar erdhi në vlerë më të ulët nga parashikimi.

7. Projekti STONEART

Bashkia Përmet është përfituese e disa projekteve në kuadër të thirrjes të thirrjes Interreg Greqi-Shqipëri 2014-2020, projekte të financuara nga Bashkimi Europian “*Zhvillimi i turizmit tematik në zonën ndërkufitare duke ruajtur mjeshhtërinë e përpunimit të gurit*” (Akronimi: STONEART).



Qëllimi i përgjithshëm i projektit është ruajtja dhe forcimi i zëjarisë dhe traditës së pëpunimit të gurit të rajoneve të Epirit dhe Shqipërisë së Jugut, si një element integral kulturor i zonës së ndërhyrjes, dhe ta vlerësojë lidhjen me zhvillimin e turizmit tematik.

Rezultatet kryesore të projektit janë:

- Depozitimi i i teknikave dhe metodave të ndërtimit të gurit;
- Atlas i Monumenteve të gurit në formatin hard dhe të dixhitalizuar
- Krijimi i markës kulturore STONE.ART;
- Modelet 3D të konstruksioneve më të rëndësishme guri të zonës
- Lojë dixhitale për të rritur dhe fëmijë në lidhje me monumentet e gurit.
- Një aplikacion udhëzues turistik me përmbajtje të pasuruar në lidhje me monumentet e gurta të zonës së bashku me informacione të dobishme turistike
- Rehabilitimi i Shkollës së Vjetër Vourbiani për të pritur të interesuarit për tu trajnuar mbi teknikat e përpunimit të gurit.
- Rregullimi i ambjentit në katin e dytë të Qendrës Kulturore, ku një sallë do të shërbejë për trajnimin e vazhdueshëm të artizanëve kurse në sallën tjetër do të paraqiten në 3D monumentet e gurit të zonës së Përmetit.
- Prodhimi i broshurave shumëgjuhëshe në teknikat e përpunimit të gurit për ndërtimin e shtëpive;
- Pjesëmarrja në Konferencën Ndërkombëtare STONE2020

KAPITULL 1					
STONEART	Vjetori	8-mujori	Fakt	% 8-MUJORE E REALIZIMIT	% VJETORE E REALIZIMIT
602	1220	1220	1148	94%	94%

Pas njohjes së shpenzimeve nga partneri kryesor , marrë parasysh dhe ndryshimet e kurseve të këmbimit nga data e faturës Nr.3/2023 datë 08.12.2023, vlera e mbëritur në llogarinë e thesarit ishte më e vogël se detyrimi që kishim ndaj shoqatës që ofroi shërbimin “Ekspertizë e jashtme”. Me dakortësinë e shoqatës (komunikim elektronik datë 12 Shkurt 2025), pjesa e mbetur e faturës u likujdua në vlerën 1 148 485.99 lekë duke mos mbetur asnjë detyrim tjetër ndaj shoqatës.

Projekti ka përfunduar zbatimin dhe në datë 22.07.2025 edhri konfirmimi i mbylljes nga Lead Partner. Aktualisht Bashkia ka dërguar shkresë pranë Ministrisë së Financave për mbyllje të llogarisë në bankën e nivelit të dytë.

8. Projekti “Përqaftimi i shpresës një oaz për ata që kanë nevojë”

Ky project i referohet tipologjisë së shërbimit : Shërbim gjysmë ditor (mbështetje psikologjike, kujdes shëndetësor, aktivitete të kohës së lirë, përfshirje në jetën social kulturore dhe 1 vakt ushqim) për kategoritë të moshuar të vetmuar, persona me PAK, pjesë e Komunitetit Egjiptian dhe individë në situatë të vështirë ekonomike.



Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti: Përmirësimi i qasjes në shërbime sociale përmes rritjes së numrit dhe llojeve të

shërbimeve që ofrohen në territorin e bashkisë. (Qëllimi 2 në planin social). Për të kontribuar në arritjen e këtij qëllimi ky projekt ka dy objektiva specifike:

Objektivi 1: Të ngrihet dhe të vihet në funksion qendra ditore e të moshuarve duke ofruar shërbime për të moshuarit dhe grupet në nevojë. (Shërbimet do të ofrohen për të moshuarit e vetmuar, personat me aftësi të kufizuara, personat në situatë vulnerabiliteti të shumëfishtë.)
Objektivi 2.3 në Planin Social

Objektivi 2: Të rrisë përfshirjen sociale të moshës së tretë dhe grupeve në nevojë në qytetin e Përmetit nëpërmjet realizimit të aktiviteteve social-kulturore.

Kohëzgjatja e zbatimit të projektit është Janar 2025- Dhjetor 2027

Rezultatet e lidhura me objektivin 1:

Funksionimi i qendrës ditore, ofrimi i shërbimeve sociale dhe 1 vakt ushqimor për këtë kategori.

Rezultati 1.1: 30 persona përfshirë të moshuar të vetmuar dhe persona të tjerë në situatë vulnerabiliteti marrin shërbim një vakt ushqimor.

Rezultati 1.2: 30 persona marrin shërbim social (mbështetje psikologjike, kujdes shoqëror, aktivitete të kohës së lirë, përfshirje në komunitet).

Rezultati 1.3: Të paktën 50 persona informohen për shërbimet sociale lehtësuese që ofrohen në Bashkinë Përmet.

Rezultati 1.4: Të paktën 50 persona marrin pjesë në aktivitetet artistike-kulturore të organizuara.

Rezultati 1.5: Të paktën 20 të rinj i bashkohen nismës “1 ditë vullnetar”.

Rezultati 1.6: Të paktën 20 të moshuar kanë një ambient të dedikuar për të kaluar kohën e lirë.

Rezultatet e lidhura me objektivin 2:

Realizim i aktiviteteve që nxisin pjesëmarrjen dhe përfshirjen e moshës së tretë në qytetin e Përmetit.

Rezultati 2.1 : Realizimi i aktivitetit “Krijojmë kujtime”.

Rezultati 2.2 : Realizimi i aktivitetit “Sporti dhe shëndeti” 6 Prill Dita Botërore e Sportit.

Rezultati 2.3 : Realizimi i eventit “ Mirënjohje ” 1 Tetori.

Rezultati 2.4 : Realizimi i aktivitetit 1 film në Kinema.

KAPITULL 1					
Fondi Social	Vjetori	8-mujori	Fakt	% 8-MUJORE E REALIZIMIT	%VJETORE E REALIZIMIT
606	3897	2832	169	6%	4%

Bashkia Përmet kishte nisur procedurat për prokurimin e ushqimeve për ofrimin e një vakti ushqimor dhe deri tani procedura e prokurimit me objekt: Blerje ushqime për ofrim vakte ushqimore në kuadër të projektit “Përqafimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë”, me fond limit 1 721 837.5 lekë pa TVSH , është anuluar 3 herë për arsye të mos paraqitjes të asnjë oferte



në SPE. Për këtë arsye i jemi drejtuar Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara për kryerjen e shërbimit të prokurimit. Gjithashtu projekti nisi zbatimin në muajin Maj për arsye të buxhetit të rishikuar nga Ministria, miratimit të vendimeve që lidheshin me ecurinë e projektit nga Këshilli Bashkiak dhe një arsye tjetër ishte periudha Mars-Maj procesi zgjedhor që kufizonte zbatimin e procedurave dhe emërimeve të reja.

Ne leke

BASHKIA PËRMET

Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiar normale dhe rastet e vështirësive financiare

Muaji Shtator 2025

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzim e vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzim e vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	2,648,974		0.69%
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore	302,088		
4864200	Det.Prap. Sherbime			
4864201	D.P.EneriElektirke	2,346,886		

4864300	Det.Prap.Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime			
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	2,648,974	381,827,182	0.69%

Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore				
Situata Normale e gjendjes fiannciare	Probleme financiare	Vështirësi financiare	Vështirësi serioze financiare	Paaftësi paguese
	Stoku i detyrimeve/Shpen zime > 15%	Stoku i detyrimeve/Shpen zime > 25%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpen zime > 80%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpen zime > 130%
Situat Normale e gjendjes financiare	0	0	0	0

BASHKIA PERMET

Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore



Nr.	E M E R T I M I	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv) 31 Gusht 2025	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan) 2025
I	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	53,321,000	74,865,000
1	Taksat e veta vendore	16,221,000	23,625,000
a.	Taksa mbi pasurinë	11,094,000	15,725,000
b.	Biznesi i vogël	39000	0
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	4,536,000	7,000,000
d.	Taksa të tjera vendore	552,000	900,000
2	Të ardhura jotatimore	30,486,000	40,240,000
a.	Tarifat e shërbimeve publike	28,812,000	39,740,000
b.	Tarifa administrative	295,000	500,000
c.	Të tjera jo tatimore	1,379,000	
3	Taksa të ndara	6,614,000	11,000,000
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	104,000	500,000
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	4,132,000	6,000,000
c.	Renta minerare		
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	2,378,000	4,500,000
e.	Të tjera		
II	Shpenzime te Buxhetit Vendor	234,659,349	557,836,683
1	Shpenzime Korrente	214,717,451	400,480,671
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga	153,425,303	259,182,148
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	25,206,100	40,968,999
d.	Shpenzime Operative	30,006,313	82,823,354
e.	Të tjera korrente	6,079,735	17,506,170
2	Shpenzime Kapitale	19,941,898	157,356,012
3	Burimet e Financimit	234,659,349	557,836,683
a.	Të ardhurat e veta vendore	37,821,533	118,474,191
b.	Transferta e pakushtezuar	122,227,626	244,693,031
c.	Transferta specifike/transferta e pakushtëzuar sektoriale	72,436,914	184,660,461
d.	Të ardhurat e pa-planifikuara (jashtë limit)	1,223,071	1,537,000
f.	Financimi i huaj	950,205	8,472,000
g.	Huamarrja Vendore Vjetore		

JU FALEMINDËRIT PËR MIRËKUPTIMIN TUAJ!

Grupi i Punës:

Alma Hoxha Kryetar

Denisa Durro Anëtar

Florand Hasani Anëtar

Aulona Meshini Anëtar

Etleva Kreci Anëtar

Vangjela Naqe Anëtar

Etleva Myftari Anëtar

Dorjan Metko Anëtar

Arjana Papapano Anëtar

Laert Bushi Anëtar

Kristjana Ibrahimimi Anëtar

Klaudja Ciko Anëtar

Bledar Tesho Anëtar

Bekim Meçani Anëtar

Maringlen Spahiu Anëtar

Fredi Lipe Anëtar

Ilia Jani Anëtar

Juxhin Pasho Anëtar

Ylli Dervishi Anëtar

